



Janar 2020

albanisch

Shko në paqe!

(Lk 7,50)

Kontakt: Meinolf Wacker
Kirchplatz 7
59174 Kamen

Tel.: +49-172-5638432
E-Mail: meinolf.wacker@go4peace.eu
Homepage: www.go4peace.eu

Hape zemrën tënde! Open your heart!

Të dashur miq të fjalës,

Prej shumë vitesh e njihja dhe e vlerësoja. Ajo kishte vendosur të martohej. Shpesh kisha pasur mundësinë të dëshmoja dashurinë mes asaj dhe të dashurit, një dashuri e sinqertë dhe e pastër. Dasma ishte përpara. Disa ditë para festës unë e mora në telefon. „A mund të bashkëndaj diçka me ty?“ më pyeti. Dhe më pas më tregoi: „Që në fillim të kësaj jave kam një errësirë në mua. Shumë ngatërresa kanë shpërthyer në familjen time dhe mes të dashurit tim. Nuk ka qënë kurrë kështu. Nuk e di pse po ndodh tani. Diçka shkatërruese është duke punuar. Zemra ime nuk është më në paqe.“

Disa minuta folëm me njëri tjetrin dhe pastaj i thashë: „A e di Mihaela, kur Zoti dëshiron të krijojë gjëra të mëdha, atëherë ka shumë fuqi që duan ta ndalojnë atë gjë. Nëse tani pak para dasmës ti je në errësirë, atëherë kjo është një shenjë, që ti po bën gjënë e duhur!“ Në fund të bisedës ajo tha: „Oh, tani zemra ime është përsëri në paqe!“ Dhe u bë një dasëm e mrekullueshme.

Siç mëkatarja e famshme në ungjillin e Lukës kishte hapur zemrën e saj dhe ishte ofruar Zotit, ajo dëgjoi nga Jezusi: „Shko në paqe!“ edhe Mihaela e kishte hapur zemrën e saj. Në një hapësirë të mbrojtur ajo kishte mundur të tregonte çdo gjë, që e rëndonte. Kjo e ndihmoi atë të gjente përsëri paqen.

Paqen me vetveten e gjen, nëse ti nuk i lejon ndjenjat dhe mendimet negative të fitojnë fuqi mbi ty. Merr gjithmonë momente qetësie. Dëgjo çfarë po ndodh në ty. Thuaje dhe jepja Zotit. Dhe nëse dëshiron, thuaja dhe një njeriu të afërt. Që paqja të vijë në ty, vlen: **Hape zemrën tënde! – Open your heart!**

për OnWordTeam

Meinolf Wacker